



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary

Nr. 107/2025
Datë: 23/07/2025

Në mbështetje të nenit 18 dhe nenit 19 (paragrafi 4) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, (GZ, nr. 7, 1 mars 2019), në përputhje me nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294 për Zyrtarët Publik, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Arsim Beqiri, Zyrtar i Lartë Ligjor në Divizionin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale caktohet në pozitën e ushtrues detyre i Udhëheqësit të Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
2. Ushtruesi i detyrës sipas pikës (1) të këtij vendimi obligohet të kryej të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
3. Të ardhurat personale të lartpërmendurit do paguhën në pajtim me koeficientin e pozitës së Udhëheqësit të Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale në Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.
4. Shfuqizohet Vendimi me nr. 91/2023 i datës 04/08/2023.
5. Obligohet Departamenti për Shërbime të Përgjithshme, Departamenti për Buxhet dhe Financa dhe Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pozita e Udhëheqësit të Divizionit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, në kuadër të Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, ka kaluar nëpër një procedurë rekrutimi, e cila ka përfunduar pa sukses dhe aktualisht mbetet pozitë e lirë.

Duke marrë parasysh natyrën specifike të Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar dhe nevojën për angazhim të plotë të burimeve të planifikuara, është e domosdoshme që Divizioni për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale të funksionojë me kapacitete të plota dhe të sigurojë vazhdimësinë e punës.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat dhe në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Anifa KALANDERI
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Arsim Beqiri;
- Kabinetit të Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamenti për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore dhe
- Arkivit.